



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.109

18 korrik

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.836, datë 11.6.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Kryezi”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 4815
Vendim i KM nr.837, datë 11.6.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Picar 1”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 4815
Vendim i KM nr.838, datë 11.6.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Zerec”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 4816
Vendim i KM nr.839, datë 11.6.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Seke”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 4816
Vendim i KM nr.840, datë 11.6.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... 4817
Vendim i KM nr.846, datë 11.6.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.306, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që do të përjashtohen nga detyrimet doganore, dhe procedurat e përjashtimit” 4818
Vendim i KM nr.847, datë 11.6.2008	Për miratimin e normës së ushqimit të efektivit gardist të Gardës së Republikës 4822

Vendim i KM nr.848, datë 11.6.2008	Për kthimin e fondeve financiare nga subjektet, që kanë përfituar nga përdorimi i fondeve të granteve japoneze, si mbështetje buxhetore “Non Project Grand Aid” (NPGA), për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit	4823
Vendim i KM nr.849, datë 11.6.2008	Për rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe ministrive e institucioneve buxhetore, për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike	4823
Vendim i KM nr.864, datë 18.6.2008	Për miratimin e rregullave teknike “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike”...	4825
Vendim i KM nr.865, datë 18.6.2008	Për përcaktimin e kriterëve, të kushteve dhe të mënyrës së financimit për arsimin, e detyrueshëm dhe të mesëm, të fëmijëve të personelit, të emëruar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja	4826
Vendim i KM nr.867, datë 18.6.2008	Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit për privatizimin e “ARMO” sh.a.....	4826
Vendim i KM nr.870, datë 18.6.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar ...	4827
Vendim i KM nr.871, datë 18.6.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar	4827
Vendim i KM nr.872, datë 18.6.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar	4828
Vendim i KM nr.873, datë 18.6.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.78, datë 4.2.2007 të Këshillit të Ministrave “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”.....	4829
Vendim i KM nr.874, datë 18.6.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.723, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar”	4829
Vendim i KM nr.875, datë 18.6.2008	Për përcaktimin e të drejtave e të detyrave dhe për procedurën e përzgjedhjes e të emërimit të kancelarit të institucioneve publike të arsimit të lartë	4830
Vendim i KM nr.877, datë 18.6.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës, për gradën shkencore “doktor””	4831

Vendim i KM nr.878, datë 18.6.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.161, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kuotave të pranimi dhe të tarifës së shkollimit për studimet specializuese afatgjata, pranë Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2007-2008”.....	4832
Vendim i KM nr.879, datë 11.6.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, komuna Topojan, të qarkut të Kukësit	4833
Vendim i KM nr.880, datë 11.6.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, bashkia Klos, të qarkut të Dibrës	4839
Vendim i KM nr.881, datë 11.6.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, komuna Xibër, të qarkut të Dibrës	4842
Vendim i KM nr.1005, datë 9.7.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për Qendrën e Publikimeve Zyrtare	4846
Vendim i KM nr.1015, datë 2.7.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të veprës “Kompleksi hidroenergjetik i hidrocentraleve mbi lumin e Valbonës, Tropojë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4846

VENDIM
Nr.836, datë 11.6.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “KRYEZI”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Kryezi”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Oberaldi” sh.p.k.
 3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kryezi”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.837, datë 11.6.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “PICAR 1”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Picar 1”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Perivoli” sh.p.k.
 3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Picar 1”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.838, datë 11.6.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “ZEREC”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Zerec”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Shaholli Energy” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Zerec”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.839, datë 11.6.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SEKE”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Seke”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Hydro-Project” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Seke”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

VENDIM
Nr.840, datë 11.6.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “VINJOLL”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “ROT” (rehabilitim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Vinjoll”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Bethalernate ” sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll” të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet rehabilitimi i këtij hidrocentrali.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.846, datë 11.6.2008

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.306, DATË 24.5.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË PAJISJEVE SPORTIVE, QË DO TË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE, DHE PROCEDURAT E PËRJASHTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 7 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.306, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. Në kapitullin II “Federata Shqiptare e Alpinizmit”, pas pikës 11 shtohen pikat, si më poshtë vijon:

- “12. Këpucë alpine;
- 13. Mushama alpine;
- 14. Kaska mbrojtëse për kokën.”.

2. Në kapitullin III “Federata Shqiptare e Boksit”, pas pikës 13 shtohet pika 14, me këtë përmbajtje:

- “14. Kompjuter për të parë pikët.”.

3. Në kapitullin IV “Federata Shqiptare e basketbollit”, pas pikës 6 shtohen pikat, si më poshtë vijon:

- “7. Topa;
- 8. Bluza;
- 9. Set medikamentesh mjekësore;
- 10. Fasha llastiku;
- 11. Kaviliere;
- 12. Kostum sportiv;
- 13. Mbathje;
- 14. Çorape;
- 15. Jelekë;
- 16. Këpucë sportive;
- 17. Çanta sportive;
- 18. Materiale didaktike stërvitore;
- 19. Libra, CD apo kasete me materiale, didaktike dhe shkencore;
- 20. Mbrojtëse topash;
- 21. Rrjeta koshash;
- 22. Aparate projektimi;
- 23. Kompjutera;
- 24. Telekamera për regjistrimin e ndeshjeve (copë 5);
- 25. Aparat fotografik (copë 5);
- 26. Faks;
- 27. Fotokopje.”.

4. Në kapitullin V “Federata Shqiptare e Çiklizmit”, pas pikës 5 shtohen pikat, si më poshtë vijon:

- “6. Foto finish, me të gjitha pajisjet përbërëse;
- 7. Veshmbathje dhe uniforma sportive (pantallonçina për çiklizëm, këpucë sportive çiklizmi, fanella, verore dhe dimërore, për çiklizëm, tuta sportive dhe mushama mbrojtëse nga shiu, kaska mbrojtëse për çiklizëm, doreza sportive;
- 8. Pajisje sportive ndihmëse, stërvitore dhe për gara (kronometër, diktofon, cilindër, kardiofrekuencimetër);
- 9. Aparatura dhe pajisje të përdorimit administrativ (kompjutera PC, laptop, fotokopje, fax, printer);
- 10. Aparatura dhe mjete të përgatitjes speciale fizike (pista ecjeje vrapimi, shtanga, gira, litarë dhe topa të ndryshëm);
- 11. Artikuj të ndryshëm, ushqimorë dhe mjekësorë;
- 12. Literaturë shkencore dhe bashkëkohore;

13. Qendra zëri dhe impiante fonie.”.
5. Në kapitullin VII “Federata Shqiptare e Futbollit”, pas pikës 25 shtohen pikat, si më poshtë vijon:
- “26. Materiale dhe aksesore të stadioneve (porta, rrjeta, flamuj, pajisje vizimi etj.)
 - 27. Pantofla;
 - 28. Shina mbrojtëse të lojtarëve dhe aksesore ndihmës (shirita kapiteni, mbajtëse flokësh, peshqirë);
 - 29. Televizorë dhe pajisje marrëse satelitore (copë 10);
 - 30. Kamera, pajisje transmetimi satelitor (copë 5);
 - 31. Manjetoфон, diktofon;
 - 32. Libra dhe revista për sportin.”.
6. Në kapitullin VIII “Federata Shqiptare e Gjymnastikës”, pas pikës 12 shtohen pikat, si më poshtë vijon:
- “13. Kalë kërcimi për femra e meshkuj;
 - 14. Rrugicë për kërcime, për garë e stërvitje;
 - 15. Trampolinë;
 - 16. Materiale, uniforma paraqitje, kanajtje, pantallona, kostume sintetike, meshkujsh e femrash, dhe mbathje (kostume gare);
 - 17. Aparatura elektronike për vlerësimin e garave.”.
7. Në kapitullin IX “Federata Shqiptare e Hendbollit”, pas pikës 10 shtohen pikat, si më poshtë vijon:
- “11. Çanta sportive;
 - 12. Shtresa plastike tartani ose ger-flowr etj., për shtrim fushe;
 - 13. Videokaseta, CD, kompjuter, printer, fotokopje;
 - 14. Mjete didaktike stërvitore (piramida, kone, pengesa etj.)”.
8. Në kapitullin X “Federata Shqiptare e Karatesë”, pas pikës 4 shtohen pikat, si më poshtë vijon:
- “5. Dhëmbëza (mbrojtëse për dhëmbët);
 - 6. Peshore elektronike;
 - 7. Tuta komplet (bluzë dhe pantallona);
 - 8. Këpucë sportive;
 - 9. Çanta sportive;
 - 10. Kronometra për stërvitje;
 - 11. Kupa sportive;
 - 12. Medalje sportive;
 - 13. Thasë lëkure për stërvitje;
 - 14. Llapeta prej lëkure për stërvitje vetjake.”.
9. Në kapitullin XI “Federata Shqiptare e Sporteve me Kuaj”, pas pikës 8 shtohet shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:
- “9. Kuaj sportivë të racave të ndryshme.”.
10. Në kapitullin XII “Federata Shqiptare e Mundjes”, pas pikës 5 shtohen pikat, si më poshtë vijon:
- “6. Tabela elektronike për mbajtjen e kohës së ndeshjeve;
 - 7. Çanta sportive;
 - 8. Kronometra për stërvitje;
 - 9. Kupa sportive;
 - 10. Medalje sportive.”.
11. Në kapitullin XIV “Federata Shqiptare e Qitjes”, pas pikës 7 shtohen pikat, si më poshtë vijon:
- “8. Aksesore dhe pjesë ndërrimi të armëve;
 - 9. Mjete optike (stereogypa) për shkimin e goditjeve;
 - 10. Aparate elektrike për ndërrimin e shenjave të qitjes;
 - 11. Shenja qitjeje prej letre.”.
12. Në kapitullin XVIII “Federata Shqiptare e Volejbollit”, pas pikës 5 shtohen pikat, si më

poshtë vijon:

- “6. Shtylla volejbolli dhe beach-volej, së bashku me mbrojtëset e tyre;
7. Kullë për gjyqtarët;
8. Rrjeta volejbolli dhe beach-volley, së bashku me antena;
9. Shtresë plastike me tartan ose me ger-flowr për fushën e volejbollit;
10. Flamur për gjyqtarët anësorë;
11. Bilbila për gjyqtarët;
12. Matëse presioni për topat;
13. Tabela me numra nga 1-22, për ndërrimin e lojtarëve;
14. Mbjatëse topash (kosha me rrota);
15. Çanta për mbajtjen e topave;
16. Uniforma sportive për gjyqtarët (Bluza, pantallona, atlete, çanta);
17. Uniforma sportive për lojtarët (bluza, mbathje, tuta sportivë, xhupa sportivë, gjunjëza, këpucë, atlete, çanta sportive);
18. Pajisje të ndryshme për përgatitjen fizike;
19. Kompjuter për mbajtjen e statistikave;
20. Literaturë, videokaseta dhe CD në ndihmë të stërvitjes së volejbollit;
21. Banera publicitare me foto nga volejbolli dhe beach-volej;
22. Tabelë elektronike për mbajtjen e pikëve gjatë garave;
23. Sinjalizues për pushimet;
24. Numëror tryeze për mbajtjen e pikëve.”.
13. Në kapitullin XXI “Federata Shqiptare e Xhudos”, pas pikës 3 shtohen pikat, si më poshtë

vijon:

- “4. Peshore elektronike;
5. Tuta komplet (bluzë dhe pantallona);
6. Këpucë sportive;
7. Çanta sportive;
8. Kronometra për stërvitje;
9. Kupa sportive;
10. Medalje sportive.”.
14. Pas kapitullit XXI shtohen kapitujt, si më poshtë vijon:
- “Kapitulli XXII “Federata Shqiptare e Tenisit”:

1. Raketa për të rritur;
2. Raketa, për fëmijë, të madhësive të ndryshme;
3. Topa të gjelbër për stërvitje;
4. Topa të gjelbër për gara;
5. Topa të butë për stërvitje;
6. Topa me kërcim mesatar për stërvitje;
7. Fije për lidhjen e raketave;
8. Makina për lidhjen e raketave;
9. Minirrjeta tenisi;
10. Shirita për lidhjen e bishtit të raketës;
11. Çanta tenisi.

Kapitulli XXIII “Federata Shqiptare e Shahut”:

1. Pajisje elektronike të fushës së shahut;
2. Kompjutera për mësimin e shahut;
3. Tabela elektronike demonstrative;
4. Ora elektronike tryeze, specifike për shahun;
5. Ora elektronike muri për shahun;
7. Fusha dhe gurë shahu (komplete);
8. Disketa, CD me programe për lojën e shahut;
9. Literaturë informative, enciklopedi, libra, revista për shahun etj.;
10. Tabela demonstrative muri, të thjeshta.

Kapitulli XXIV “Federata Shqiptare e Bowling”:

1. Pjesë këmbimi mekanike, elektrike e elektronike;

2. Solucione për pastrimin dhe mirëmbajtjen e pistave të bowling-ut;
 3. Topa bowling-u;
 4. Këpucë për sportistët (që përdoren gjatë linjës);
 5. Birila për lojën e bowlingut.
- Kapitulli XXV “Federata Shqiptare e Bilardos”:
1. Tryeza bilardoje (të tipave dhe të përmasave të ndryshme, Pool Snooker, Carom, Birila);
 2. Steka të tipave të ndryshme;
 3. Aksesorë për tryezat e bilardos (llambadarë, gurë, bilardo, copë për veshje tryezash bilardoje, mbajtëse stekash, sahatë elektronikë, sahatë mbajtës të gurëve, gropa, xhepa, trekëndësha, stanok, kupa etj.
- Kapitulli XXVI “Federata Shqiptare e Bodybiling”:
1. Boshte shtange dhe pesha të ndryshme;
 2. Gira;
 3. Makineri (biçikleta statike, makina vrapimi, makina të ndryshme për stërvitjen e grupmuskujve).
- Kapitulli XXVII “Komiteti Olimpik Shqiptar”:
1. Materiale promocionale për ekipin olimpik shqiptar;
(Stema, emblema, mbajtëse çelësash, veshje sportive (bluzë tute, tuta, kapele, këpucë sportive), manuale;
 2. Veshje përfaqësimi zyrtar (kostume për femra dhe meshkuj, këmisha, këpucë);
 3. Aksesorë të ndryshëm për delegacionet sportive zyrtare (flamuj, postera, videofilma, mbajtëse të flakës olimpike, pishtar).”.

VENDIM
Nr.847, datë 11.6.2008

PËR MIRATIMIN E NORMËS SË USHQIMIT TË EFEKTIVIT GARDIST TË GARDËS SË REPUBLIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Efektivi gardist i Gardës së Republikës të trajtohet me normën ditore të ushqimit, të përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Efekti financiar, që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 231 000 (dyqind e tridhjetë e një mijë) lekë, për racion ditor, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Gardën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Vendimi nr.394, datë 12.8.1999 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normës së ushqimit të efektivit ushtarak të Gardës së Republikës”, shfuqizohet.
 4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

NORMA E USHQIMIT PËR EFEKTIVIN GARDIST TË GARDËS SË REPUBLIKËS

Nr	Artikulli	Njësia e matjes	Sasia
1.	Bukë	gr.	600
2.	Oriz	gr.	70
3.	Makarona	gr.	70
4.	Fasule	gr.	70
5.	Mish viçi i freskët	gr.	190
6.	Vaj gatim	ml.	30
7.	Vaj (ulliri)	ml.	10
8.	Gjalpë	gr.	30
9.	Sheqer	gr.	50
10.	Djathë i bardhë	gr.	40
11.	Qumësht	ml.	300
12.	Vezë	kokrra	1
13.	Perime për gatim	gr.	350
14.	Perime për sallatë	gr.	150
15.	Fruta të freskëta	gr.	250
16.	Reçel	gr.	30
17.	Salcë	gr.	3
18.	Çaj mali	gr.	1
19.	Kripë	gr.	10

VENDIM
Nr.848, datë 11.6.2008

**PËR KTHIMIN E FONDEVE FINANCIARE NGA SUBJEKTET, QË KANË PËRFITUAR
NGA PËRDORIMI I FONDEVE TË GRANTEVE JAPONEZE, SI MBËSHTETJE
BUXHETORE “NON PROJECT GRAND AID” (NPGA), PËR SEKTORIN E BUJQËSISË
DHE TË USHQIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlera e linjave teknologjike të agropërpunimit, të financuara nga grantet japoneze, si mbështetje buxhetore nga NPGA (Non Project Grand Aid), në përputhje me vendimet nr.485, datë 21.10.1999 dhe nr.419, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, të shlyhen, si fonde kundërparti, nga subjektet përfutuese, me vlerën e barasvlefshme në lekë të çmimit të blerjes FOB, e konvertuar në lekë, me kursin e datës së miratimit të këtij vendimi, me këste, pa interes, deri në qershor të vitit 2013. Diferencat financiare, ndërmjet çmimeve CIF dhe FOB, të evidentohen nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor, 2 KR”, në pakësim të fondeve kundërparti.

2. Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor, 2 KR” të lidhë kontratat e shitjes me rezervë, me

subjektet përfituese të NPGA-së (Non Project Grand Aid). Kriteret, afatet dhe sanksionet, në bazë të të cilave do të lidhen këto kontrata, të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrisë së Financave.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.849, datë 11.6.2008

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËS,
ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA DHE MINISTRIVE E
INSTITUCIONEVE BUXHETORE, PËR MBROJTJEN E SHITRESAVE NË NEVOJË NGA
RRITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 27.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrive dhe institucioneve buxhetore, në buxhetet e miratuara për vitin 2008, t’u shtohet fondi 110 458 500 (njëqind e dhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për kryerjen e pagesës shitresave në nevojë, për mbrojtjen nga rritja e çmimit të energjisë elektrike.

2. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, programi “Mbrojtja sociale” (Gr.25, Tit.10430, Kap.1, Art.606), t’i pakësohet fondi prej 110 458 500 (njëqind e dhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekësh.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

LISTA E INSTITUCIONEVE PËR ENERGJINË ELEKTRIKE 2008

në lekë

Kod.Min	Emërtimi i institucionit	Fondet Viti 2008
1	Presidenca	48 000
2	Kuvendi	24 000
4	Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	150 000
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	1 446 000
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1 086 000
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	70 000 000
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	444 000

13	Ministria e Shëndetësisë	19 635 500
16	Ministria e Brendshme	1 308 000
17	Ministria e Mbrojtjes	9 497 000
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	787 000
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	4 680 000
28	Prokuroria e Përgjithshme	540 000
29	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	609 000
30	Gjykata Kushtetuese	66 000
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	72 000
55	Shkolla e Magjistraturës	6 000
67	Komisioni i Shërbimit Civil	6 000
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive	30 000
77	Autoriteti i Konkurrencës	6 000
78	Ministria e Integrimit	18 000
	Totali	110 458 500

VENDIM
Nr.864, datë 18.6.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PËRPUTHSHMËRISË ELEKTROMAGNETIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave teknike “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.865, datë 18.6.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË KUSHTEVE DHE TË MËNYRËS SË FINANCIMIT PËR ARSIMIN, E DETYRUESHËM DHE TË MESEËM, TË FËMIJËVE TË PERSONELIT, TË EMËRUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË

SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 46 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të personelit të përfaqësisë diplomatike, në vendet ku shkollimi publik, i detyrueshëm dhe i mesëm, është me pagesë, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, deri në përfundim të arsimit të mesëm.

2. Shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të personelit, të emëruar në përfaqësitë diplomatike, në vendet, ku kushtet e ushtrimit të detyrës përballen me vështirësi të veçanta ose ku sistemi shkollor zhvillohet në gjuhë të ndryshme nga gjuhët e huaja, që mësohen në sistemin arsimor shqiptar, të përballohen pjesërisht nga buxheti i përfaqësisë, kur shkollimi i fëmijëve bëhet në shkolla ndërkombëtare private, të njohura, të licencuara apo homologuara nga autoritetet vendase.

3. Kërkesa e nëpunësit për mbulimin e shpenzimeve të arsimit në institucionin arimor privat i drejtohet Ministrit të Punëve të Jashtme, së bashku me një kopje të licencës së institucionit, lëshuar nga organet kompetente të vendit, dhe me vërtetimin origjinal nga ky institucion, për koston e shkollimit, me hollësitë përkatëse.

4. Pas miratimit të kërkesës nga ministri, në bazë të dokumentacionit të paraqitur prej nëpunësit të emëruar, përfaqësia, nga buxheti i vet, përballon shpenzimin deri në shumën 250 euro ose 250 USD në muaj, për çdo fëmijë, deri në përfundim të arsimit të mesëm.

5. Në raste të veçanta, kur, me dokumente, vëretohet se shuma e parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi është më e vogël se 50 për qind e shpenzimit mujor për shkollim për fëmijë, me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme mund të përcaktohet një vlerë më e lartë, deri në 50 për qind të koston e shkollimit.

6. Me pagesë shkollimi kuptohen shpenzimet për mësimdhënie, ndërsa shpenzimet e tjera, si pagesa e librave, transporti, pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme kulturore-sportive etj., përballohen nga vetë nëpunësi i përfaqësisë diplomatike.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

8. Vendimi nr.721, datë 21.12.2000 i Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve të punonjësve tanë, që punojnë në përfaqësitë tona diplomatike”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.867, datë 18.6.2008

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE DHE SHPALLJEN E FITUESIT PËR PRIVATIZIMIN E “ARMO” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “ARMO” dhe në vijim të vendimit nr.82, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e instruksioneve për paraqitjen, hapjen dhe vlerësimin e ofertave për privatizimin e “ARMO” sh.a.-së”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave për privatizimin e “ARMO” sh.a.-së, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të vendimit nr.82, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe klasifikimin e kandidatëve, si më poshtë vijon:

- Refinery Associates of Texas,
Anica Enterprises & Mercuria Energy Group 93.16 pikë;
- Vitol, Euroil sha, NFS Partners
SA and USBCF Inc 69.49 pikë;
- Petrofac Energy Developments International
Limited 30.52 pikë.

2. Shpalljen fitues të ofertës së paraqitur nga kandidati “Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që, në bazë të klasifikimit të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, të fillojë negociimet dhe nënshkrimin e marrëveshjes me kandidatin fitues “Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group”, sipas kapitullit VIII, pikat 2 e 3, të vendimit nr.82, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.870, datë 18.6.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.7.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe të Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalja e parë e pikës 4 të vendimit nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Masa e përfitimit për shkak të verbërisë është 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që përfitojnë nga shteti.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë, përballohen nga fondet e buxhetit të vitit 2008, grupi 25, titulli 064, kapitulli I, artikulli 606, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.871, datë 18.6.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjala e parë e pikës 4 të vendimit nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Masa e përfitimit për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, është 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që përfitojnë nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 700 000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, të përballohen nga fondet e buxhetit të vitit 2008, grupi 25, titulli 064, kapitulli I, artikulli 606, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.872, datë 18.6.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE
MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, e 20, pika 3, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Masa e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar, të përcaktuar sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, është 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi.”.

b) Në pikën 9 fjalët “...përfitojnë 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj...”

zëvendësohen me “...përfitojnë pagesë sa dyfishi i masës së përfitimit, të përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi...”.

c) Në pikën 10 fjalët “...përfitojnë 21 000 (njëzet e një mijë) lekë në muaj...” zëvendësohen me “...përfitojnë pagesë sa trefishi i masës së përfitimit, të përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi...”.

ç) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Pagesa e kujdestarit të personit me aftësi të kufizuar, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, është në masën 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e kësaj pagese të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi.”.

d) Pika 15 shfuqizohet.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 240 (dyqind e dyzet) milionë lekë, të përballohen nga fondi i buxhetit të vitit 2008, grupi 25, titulli 064, kapitulli 1, artikulli 606, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.873, datë 18.6.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.78, DATË 4.2.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË
PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.78, datë 4.2.2007 të Këshillit të Ministrave, fjalët “...në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj...” zëvendësohen me “...në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj...”.

2. Efektet financiare, prej 36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e buxhetit të vitit 2008, grupi 25, titulli 064, kapitulli 1, artikulli 606, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.874, datë 18.6.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.723, DATË 19.11.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E
INVALIDIT”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.723, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “...është 4 000 lekë...” zëvendësohen me “...është 6 000 (gjashtë mijë) lekë...”.

2. Efektet financiare, prej 4 800 000 (katër milionë e tetëqind mijë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontigjencës, miratuar në buxhetin e vitit 2008, grupi 25, titulli 10220, kapitulli 1, artikulli 606, zëri “Transferime korente të brendshme”, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.875, datë 18.6.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E TË DREJTAVE E TË DETYRAVE DHE PËR PROCEDURËN E
PËRZGJEDHJES E TË EMËRIMIT TË KANCELARIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kancelari i institucionit publik të arsimit të lartë (më poshtë kancelari) është autoritet, në përbërje të rektoratit të institucionit publik të arsimit të lartë (më poshtë institucioni). Kancelari, për përmbushjen e funksionit, kryen detyrat e mëposhtme:

- a) Drejton veprimtarinë e administratës;
- b) Realizon administrimin financiar;
- c) Drejton planifikimin dhe realizimin e investimeve;
- ç) Mbikëqyr të gjitha procedurat e marrjes në punë;
- d) Drejton procedurat e marrjes në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të administratës;

dh) Me autorizimin e rektorit, përfaqëson ose bashkëpërfaqëson institucionin në të gjitha proceset gjyqësore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palët e treta, persona, fizikë ose juridikë;

e) Kryeson sekretariatin teknik, që mbështet veprimtarinë e këshillit të administrimit të institucionit (më poshtë KADM);

ë) Mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit.

2. Për përzgjedhjen dhe emërimin e kancelarit të institucionit ndiqen procedurat e mëposhtme:

- a) KADM-ja miraton kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët;
- b) Institucioni shpall publikisht, për dy javë kalendarike, vendin e punës dhe kriteret, që duhet

të plotësojnë kandidatët për kancelar, si dhe shpall fillimin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve, nëse janë paraqitur, së paku, tri kandidatura;

c) KADM-ja harton skemën e vlerësimit të kandidatëve duke përshkruar me hollësi mënyrën e vlerësimit të kandidatëve, në bazë të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Përveç vlerësimit të dosjes mund të parashikojë edhe një intervistë;

ç) Çdo anëtar i KADM-së bën vlerësimin, me shkrim, sipas skemës së miratuar, për çdo kandidat, dhe në fund, në bazë të pikëve të grumbulluara, shpallet renditja e kandidatëve;

d) KADM-ja ka të drejtë të përzgjedhë, me votim të fshehtë, njërin nga tri kandidatët, që kanë grumbulluar më shumë pikë. Fitues shpallet kandidati, që merr 2/3 e votave të anëtarëve.

dh) KADM-ja, pasi bën përzgjedhjen e kandidatëve, shpall publikisht kandidaturën fituese.

